

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË ERSEKË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Ersekë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 62, datë 14.05.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 110/8, datë 14.05.2015, i ka rekomanduar z. Ali Jaho, Kryetar i Bashkisë Ersekë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE.

1.Gjetje: Nuk është arkëtuar detyrimi në vlerën 7,110 lekë, nga z. O.B rekomandim i mëparshëm i lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas shkresës nr. 288/5, datë 26.10.2010.

Rekomandimi: Bashkia Ersekë, të marrë masa për të arkëtuar detyrimin e O.B **7,110 lekë**, rekomandim i lënë nga KLSH sipas shkresës nr. 288/5 prot, datë 26.10.2010, duke zbatuar të gjitha procedurat administrative dhe ligjore.

Brenda datës 30.07.2015

1.2. Gjetje: Shpenzimet operative janë planifikuar dhe realizuar në nivele të larta dhe në raport të zhdrejtë me shpenzimet për paga, si rezultat i një planifikimi të pa saktë dhe të pa studiuar. Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paaftësinë për vitin 2014 zënë peshën kryesore 45 % dhe janë rritur krahasuar me vitin 2013.

Rekomandimi: Bashkia Ersekë të marrë masa për rregullimin e raportit të shpenzimeve operative, duke ulur nivelin e tyre, si rezultat i një planifikimi të saktë dhe të studiuar, për efekt të efijencës, ekonomicitetit dhe efektivitetit të shpenzimeve operative. Njëkohësisht, të marrë masa për uljen e shpenzimeve të ndihmës ekonomike, duke nxitur punësimin dhe përmirësuar politikat sociale, për efekt të zbutjes të papunësisë dhe nivelit të varfërisë.

Në Vijimësi

3. Gjetje: Bashkia Ersekë ka aplikuar normativa të larta të konsumit të karburantit për 2 automjetet e saj, të cilat nuk janë efektive dhe nuk janë kryer matjet sipas procedurave ligjore.

Rekomandimi: Bashkia Ersekë të marrë masa,duke ngritur grup pune me specialistët p1rkatës dhe të llogariten saktë dhe dokumentohen normat e harxhimit të karburantit, për automjetet që ka në shërbim të përmbushjes së detyrimeve në shërbimet e administratës dhe shërbimet publike.

Brenda datës 30.07.2015

4. Gjetje: Nuk janë zbatuar procedurat e përzgjedhjes së punonjësve të policisë bashkiake, pasi nuk kanë arsimin përkatës të Akademisë Rendit, nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar komisioni i posaçëm. Nuk ka kontrata 3-vjeçare të lidhura me këta punonjës, sipas kriterëve të Rregullores Brendshme "TIP" të Policisë të Bashkisë, të miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Rendit, nr. 1, datë 17.04.2003, neni 11 dhe 7, “Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi” pikat 2 dhe 5, me nenin 4, të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, “Për Organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë”, i ndryshuar, me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998.

Rekomandimi: Bashkia Ersekë të marrë masa, për ngritjen e komisionit të posaçëm për emërimin e punonjësve të policisë bashkiake, si dhe të vendoset kriter që konkurrentët të kenë mbaruar Akademinë e Rendit dhe të lidhen kontratat 3-vjeçare sipas kërkesa ligjore.

Në Vijimësi

5.Gjetje:Nga verifikimi i numrit të familjeve të qytetit të Ersekës, të cilat janë subjekte për taksat dhe tarifatat vendore, rezultoi se nuk janë rakorduar detyrimet e llogaritura për vitin 2013 dhe 2014 në vlerën 108,228 lekë, të cilat rezultojnë të pa përfshira në bilancin kontabël.

Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore në bashkëpunim me Zyrën e financës, të hartojnë një plan masash, ku të detajohen veprimet konkrete me afate të përcaktuara, për verifikimin dhe saktësimin e të dhënave në regjistrat e administrimit të detyrimeve vendore, sipas blloqeve të dhëna nga Ndërmarrja e Ujësjetësimit sh.a, si dhe duke u mbështetur në të dhënat e pasqyruara në bilancin e vitit 2014, të përcaktohen debitorët familjarë për llogaritjen, njoftimin dhe arkëtimin e shumës **108,228 lekë**.

Brenda datës 30.07.2015

6.Gjetje:Nga auditimi i menaxhimit të borxhit rezultoi se: **9 subjekte juridike me borxh me vlerë 318,200 lekë dhe 32 subjekte fizike për 609,742 lekë**, nuk janë njoftuar për detyrimet dhe nuk janë llogaritur penalitetet me 25% të detyrimit për mos pagim të taksave në afatin e caktuar, për vlerën 231,991 lekë penalitete, nga e cila 79,555 lekë u përkasin subjekteve juridike dhe 152,436 lekë subjekteve fizike. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05. 2008 “*Për Procedurat Tatimore në RSH*”, i ndryshuar, neni 89.

Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore të marrë masa dhe të njoftojë 9 subjektet juridike për detyrimin(borxh) në vlerën **318,200 lekë** dhe 32 subjekte fizike në vlerën **609,742 lekë**, si dhe të llogariten penalitetet në masën 25% të detyrimit për vlerën **231,991 lekë**, duke kërkuar arkëtimin e tyre dhe në bashkëpunim me Zyrën e financës, të kryhet regjistrimi dhe pasqyrimi në bilancin e vitit 2015.

Brenda datës 30.07.2015

7.Gjetje:Nga verifikimi në regjistrin e administrimit të taksave dhe tarifave vendore, u konstatuan subjekte, të cilat nuk janë ndjekur dhe monitoruar në vijimësi, duke bërë që të mos gjenerohen detyrimet për shumicën e tyre, të mos kontrollohen dhe detyrohen të shlyejnë detyrimet .

Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore të marrë masa, duke kryer verifikimin e regjistrit për administrimin e taksave vendore në terren, duke bërë verifikimin e të dhënave me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, Ersekë dhe QKR, statusin e tyre e bërë njoftimet përkatëse për detyrimet që do rezultojnë.

Brenda datës 30.07.2015

8.Gjetje:Nga auditimi i bilancit të vitit 2014 në lidhje me tepricën e llogarisë 312 dhe 327, u konstatuan një diferencë për vlerën 202,522 lekë, e dalë nga krahasimi i gjendjes së paraqitur në llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” , formati 3/1 “Përshkrimi i shpenzimeve të ushtrimit”.

Rekomandimi: Zyra e financës të sistemojë diferencën e llogarisë 312 dhe 327 për vlerën **202,522 lekë** duke saktësuar në formatin 3/1 “Përshkrimi i shpenzimeve të ushtrimit” nga 2,458,813 lekë që është paraqitur në vlerën 2,661,335 lekë.

Brenda datës 30.07.2015

9.Gjetje: Konstatohet se pa u përfunduar objekti, pa akt kolaudim dhe akt marrje në dorëzim të investimit “*Rikonstruksion i sheshit Rilindja Ersekë*”, është bërë veprimi i mbylljes së investimit, duke e evidentuar në zërin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, llogarinë 213 “*Rrugë , rrjete, vepra ujore*” për vlerën 36,969,572 lekë, ndërkohë që investimi vazhdon, në vend që shumata e mësipërme duhej të qëndronte në llogarinë “*investime në proces*”, në kundërshtim me ligjin 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”.

Rekomandimi: Financa të sistemojë vlerën 36,969,572 lekë në llogarinë “*investime në proces*”, pasi investimi “*Rikonstruksion i sheshit Rilindja Ersekë*”, është në proces.

Brenda datës 30.07.2015

10. Gjetje nga auditimi:

-Në 4 procedura prokurimi të zhvilluara nga autoriteti kontraktues nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe Specifikimeve Teknike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, pika 2/c, Kreu II dhe nenet 15 dhe 22Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri për kualifikim në tenderin me objekt “*Rikonstruksion i sheshit Rilindja*”, në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik,

të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar. Kërkesat për kualifikim, si të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë, si rrjedhojë e mosbarazime në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

Rekomandim: Bashkia Ersekë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të forcojë kontrollin e brendshëm në lidhje me procedurat e planifikimit të fondit limit dhe prokurimit, konkretisht në parashikimin e nevojës për prokurim, kërkesë për prokurim dhe miratimi i saj, hartimi dhe miratimi i urdhrat për zgjedhjen e procedurës së prokurimit.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktues nuk ka bërë arkivimin e procedurës së prokurimit në sistem, në kundërshtim me udhëzimin e APP-së.

Rekomandim: Bashkia Ersekë të marrë masat që, me përfundimin e procedurave të prokurimit, të kryhet inventarizimi e brendshëm i dosjeve, në përputhje me nenin 30, “Modeli nr. 8 “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Brenda datës 30.06.2015

12. Gjetje: U konstatuan të ardhura të munguara nga taksat dhe tarifat vendore për vlerën 941,403 lekë, nga kjo:

-vlera 544.120 lekë, për ushtrim aktiviteti pa u pajisur me certifikatën e regjistrimit, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2013 dhe 2014 për 25 subjekte të biznesit të vogël.

-vlera 397,283 lekë për penalitete të pa llogaritura, nga moszbatimi i afateve të likuidimit të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, sipas përcaktimeve të nenit 114 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **941,403 lekë**, përkatësisht:

-vlera 544.120 lekë, për ushtrim aktiviteti pa u pajisur me certifikatën e regjistrimit, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2013 dhe 2014, për 25 subjekte të biznesit të vogël (sipas aneksit nr. 4 dhe 5) .

-vlera 397,283 lekë, për penalitete të pa llogaritura dhe mos respektim të afateve të likuidimit të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, nga subjektet sipas anekseve nr. 1,2,3 .

Brenda datës 30.05.2015

13. Gjetje: Nga riverifikimi i objektit “Rikonstruktion i sheshit Rilindja”, u konstatua se në kryerjen e pagesave në vlerën 20 milion lekë pa tvsh, në favor të subjektit kontraktues “AS shpk”, pa dokumentacionin e plotë dhe rezulton se punimet janë kryer jo plotësisht sipas situacionit përkatës, investim ky që është në proces mbyllje brenda muajit Qershor 2015. Ky objekt ka ndryshim projekti nga Ministria e linjës, për tu kthyer në pedonale. Kjo është e argumentuar me akt verifikimin datë 29.4.2015, kryer sipas kërkesës nr. 379 datë 22.4.2015 të Bashkisë Ersekë.

Rekomandimi: Bashkia Ersekë, t'i kërkojë sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit të punimeve që të marrin masa për zbatimin e plotë të punimeve të ndërtimit të objektit, në përputhje me kërkesat dhe detyrat e projektit të zbatimit të miratuar, kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, si dhe destinacionit të tij pa shmangie në drejtimin funksional, duke siguruar cilësinë e materialeve të përdorura dhe të objektit në tërësi.

Brenda datës 20.07.2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe administrative, në të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbartimore, me qëllim arkëtimin e vlerës **14,769,000 lekë dëm ekonomik**, konkretisht:

1. Gjetje: U konstatua se disa Këshilltar Bashkiak janë paguar padrejtësisht për vlerën **445,200 lekë dëm ekonomik**, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këtij këshilli për vitin 2013

dhe 2014 sipas protokollit të mbledhjes të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 16.01.2013, nr. 3, datë 1.3.2013, nr. 4, datë 26.03.2013, nr. 5, datë 30.4.2013, nr. 6, datë 6.6.2013, nr. 9, datë 30.8.2013, nr. 10, datë 4.10.2013, nr. 2, datë 28.02.2014, nr. 3, datë 28.3.2014, nr. 6, datë 18.7.2014, nr. 8, datë 2.10.2014 dhe nr. 9, datë 10.11.2014, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Rekomandimi: Bashkia Ersekë të marrë masa dhe të kryej arkëtimin e vlerës **445,200 lekë**, për pagesa të paligjshme, nga këta këshilltarë: I.Q 26,560 lekë për 4 muaj, V.D 53,120 lekë për 8 muaj, M.H 53,120 lekë për 8 muaj, A.Q 59,760 lekë për 9 muaj, P.P 26,560 lekë për 4 muaj, P.C 46,480 lekë për 7 muaj, O.M 26,560 lekë për 4 muaj, E.C 46,480 lekë për 7 muaj, Q.K 26,560 lekë për 4 muaj, Z.M 19,920 lekë për 3 muaj, A.J 6,800 lekë për 1 muaj, T.A 19,920 lekë për 3 muaj, A.K 26,560 lekë për 4 muaj dhe R.H 6,800 lekë për 1 muaj.

Brenda datës 30.09.2015

2. Gjetje. Në blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla, u konstatuan shkelje për vlerën **221,985 lekë dëm ekonomik**, përkatësisht:

-vlera 20,420 lekë, për mallra e artikuj ushqimor blerë me çmime më të larta se tregu, sipas urdhër shpenzimeve nr. 554, 556, 557, datë 16.12.2014, në kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 2, datë 28.3.2013 “Për procedurën prokurimit me vlera vogla”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik”.

-vlera 201,565 lekë, për mirëmbajtje objekti dhe blerje materiale ndërtimi, sipas urdhër shpenzimit nr. 358 datë 21.11.2013, rezulton se shpenzimi nuk argumentohet, pasi mungon preventivi, situacioni dhe akt marrja në dorëzim e objektit i cili nuk ka adresë. Gjithashtu faturat e subjektit nr. 54 datë 30.4.2012, nr. 52 datë 30.4.2012, nr. 62 datë 27.6.2012, nr. 39 datë 31.12.2012 janë të parregullta në plotësimin e tyre, veprime në kundërshtim me pikë 36 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **221,985 lekë**, përkatësisht:

-vlera 20,420 lekë, për diferenca çmimi blerje në artikuj ushqimor, nga komisioni i blerjeve të vogla, J.D 6,807 lekë, T,Th 6,807 lekë dhe S.V 6,806 lekë.

-vlera 201,565 lekë, shpenzim i pajustificuar dhe pa identifikim të objektit të meremetuar, nga komisioni i blerjeve të vogla, Th.A 67,288 lekë, G.C 67,288 lekë dhe S.V 67,289 lekë.

Brenda datës 30.09.2015

3. Gjetje: Për vitin 2013 dhe 2014, shpenzimet celulare të kryetarit Bashkisë janë tejkaluar mbi normativën ligjore për vlerën **100,000 lekë dëm ekonomik**, pasi ka përfituar padrejtësisht mbi 4,000 lekë në muaj, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave juridikë, publikë”, pika 9, me VKM nr. 589, datë 5.9.2012 “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2012” pika 2.

Gjithashtu janë bërë dalje 33 karta celulare pa mbështetje ligjore, sipas flet daljeve nr. 367, datë 2.7.2014 dhe nr. 264, datë 6.5.2014 për **33,000 lekë dëm ekonomik** z. I.Q këshilltar.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **133,000 lekë**, nga këto:

- z. A.L, **Kryetar i Bashkisë** vlerën **100,000 lekë** për tejkallim normative të shpenzimeve celulare, për vitin 2013 dhe 2014,

-z. I.Q, **këshilltar** për vlerën **33,000 lekë**, për shpenzime celulare të pajustificuara.

Brenda datës 30.06.2015

4. Gjetje: Është konstatuar vlera **88,920 lekë dëm ekonomik**, përfituara tepër dieta dhe me dokumentacion të parregullt, sipas urdhër shpenzimit nr. 572 datë 22.12.2014, nr. 456, datë 21.10.2014 dhe nr. 146 datë 7.6.2013, në kundërshtim me VKM nr. 997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”(Trajtuar më hollësisht në faqet 29-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi:Të arkëtohet vlera **88,920 lekë**, për sa përfituar dieta tepër, përkatësisht: A.L vlera 27,500 lekë, A.D 17,500 lekë, P.R 5,000 lekë, B.M 15,000 lekë, Th.A 7,500 lekë, L.Q 3,920 lekë, O.L 7,500 lekë dhe G.C 5,000 lekë.

Brenda datës 30.09.2015

5. Gjetje: Nuk është zbritur nga pagesa ,firmës pastrimit *K.... shpk*, zëri i punës “*fshirje të sheshit Rilindja të qytetit*” për sipërfaqen 3,296 m2, që bën fjalë për rikonstruksionin e sheshit të qytetit me tenderim, sipas kontratës datë 25.7.2014, për vlerën 736,200 lekë dëm ekonomik përfituar tepër për punë të pakryer, sipas urdhër shpenzimeve nr. 574, datë 22.12.2014, nr. 595, datë 29.12.2014, nr. 454, datë 20.10.2014, nr. 465, datë 27.10.2014 si dhe situacionit Janar dhe Shkurt 2015, në kundërshtim me nenin 12 , 17, 20 të kontratës sipërmarrëse datë 3.5.2010, me nenin 18, kapitulli i IV, pika 1, 2/a,b etj të rregullores brendshme të bashkisë, miratuar në KB sipas Vendimit nr. 22, datë 21.4.2010, me Udhëzimin i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **736,200 lekë** nga firma e pastrimit *K..... shpk*, përfituar tepër për **punë të pakryer** në zërin “*fshirje te sheshit Rilindja te qytetit*”, për sipërfaqen 3,296 m2, e cila i është nënshtruar rikonstruksionit, për muajt Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor 2014 dhe Janar 2015,.

Brenda datës 30.06.2015

6. Gjetje: U konstatuan në 5 raste shpenzime të pa shoqëruara me një dokumentacion të parregullt për vlerën **137,645 lekë dëm ekonomik**, për dreka me punonjësit e bashkisë me rastin e disa festave gjatë vitit 2013, konkretisht sipas urdhër shpenzimit nr. 382, datë 12.12.2013 është shpenzuar vlera 39,300 lekë për një drekë me rastin e festës 28-29 Nëntorit 2013, sipas urdhër shpenzimit nr. 359, datë 21.12.2013 është shpenzuar vlera 15,300 lekë për një drekë me rastin e festës 20 tetorit 2013, sipas urdhër shpenzimit nr. 138, datë 24.5.2013 dhe nr. 139, datë 30.5.2013 është shpenzuar vlera 50,000 lekë, që bën fjalë për 2 dreka për 28-29 nëntorin 2012, sipas urdhër shpenzimit nr. 226, datë 23.8.2013 është shpenzuar vlera 22,045 lekë, për 1 drekë me rastin e 5 majit 2013.

Sipas urdhër shpenzimit nr. 360, datë 21.11.2013 është shpenzuar për një drekë me rastin e pritjes së një Ambasadori, rezulton se është tejkaluar raporti ligjor ½ i pjesëmarrjes të personave huaj me ata vendas, si dhe është tejkaluar kuota ligjore për vlerën **11,000 lekë**.

Veprime në kundërshtim me pikën 1/c dhe 9 të VKM nr. 243 datë 15.05.1995 “*Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin e delegacioneve të huaja*” të ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999, me UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “*Për procedurat standarde zbatimit të buxhetit*”, pika 114 e kapitullit II. 3 “*Buxhetit vendor*”, me pikën 1/b të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “*Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore*”, me pikën 5 të VKM nr. 432 datë 28.06.2006 “*Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore*”.

Rekomandimi: Të analizohen në Këshillin Bashkiak këto pagesa dhe pas vendimit të kryhen veprimet përkatëse për sistemimin e vlerës **137,985 lekë**.

Brenda datës 30.07.2015

7. Gjetje: Nga auditimi i dokumentacionit të përdorimit të mjetit tip *Jeep* të administratës, rezultoi se:

-Nuk rakordojnë disa fletudhëtime me urdhër shërbimet, të nënshkruara nga Kryetari i bashkisë, për vlerën **12,500 lekë dëm ekonomik**, sipas fletudhëtimeve datë 3, 10, 11, 12.3. 2014 pasqyrojnë *linjën Erseke-Korçe-kthim*, ndërsa urdhër shërbimet pasqyrojnë linjë tjetër *Erseke-Tiranë-kthim*, sipas fletudhëtimeve datë 18 dhe 19.9. 2014. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **12,500 lekë**, për *dieta tepërta*, nga z.A.L Kryetar i Bashkisë.

Brenda datës 30.06.2015

8. Gjetje: Nga auditimi i dokumentacionit kamionit të bashkisë *Volvo*, rezultoi se:

-Disa fletudhëtime për vitin 2013 dhe 2014, janë plotësuar padrejtësisht në rrethe fqinj, jashtë destinacionit të miratuar për pastrimin në territorin e bashkisë, të cilat nuk justifikojnë harxhimin e 412 litrave karburant për vlerën **73,336 lekë dëm ekonomik**.

-Nga rakordimi vjetor 2013 për km e përshkuara (1582 km) krahasuar me furnizimet (691 litra) dhe normativat e karburantit (552 litra $1582 \times 33/100$) sipas procesverbaleve të komisionit datë 31.5.2013, datë 22.10.2013 dhe datë 31.12.2013, rezultoi se diferenca 139 litra karburant (691-552 x 178) për vlerën 24,742 lekë dëm ekonomik nuk justifikohet me dokumente.

-Nga rakordimi vjetor 2014 për km e përshkuara (2,669) –furnizimet (943) -normativat e karburantit (33/100), sipas procesverbaleve të komisionit datë 01.4.2014, datë 31.7.2014, datë 1.9.2014, datë 1.10.2014, datë 3.11.2014 dhe datë 01.12.2014, rezulton diferenca e pajustificuar për 60 litra karburant me vlerën 10,680 lekë dëm ekonomik, për drejtuesin e kamionit.

Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik” .

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **108,758 lekë** (73,336+24,742+10,680), përkatësisht nga Th.A 36,254 leke, G.C 36,252 lekë dhe B.Mi 36,252 lekë, për përdorim karburanti dhe të pa justifikuar me dokumente, jashtë destinacionit të miratuar dhe për diferenca karburanti të rezultuara, nga rekordimi i km të përshkuara-furnizimet-normativat për vitin 2013 dhe 2014.

Brenda datës 30.09.2015

9. Gjetje: Fletëdaljet dhe përdorimin e artikullit “pelet”, për ngrohje në shkollën 9-vjeçare dhe kopshtin nr. 1 për vitin 2013 dhe 2014, në disa raste kanë parregullsi, pasi kjo lëndë djegëse është bërë dalje edhe për periudhën e pranverës dhe për ditë festash zyrtare, si dhe janë përfshirë orë të tepërta pune në grafiket mujore, çka e bën shpenzimin e pa argumentuar dhe nuk justifikon harxhimin, duke krijuar vlerën **27,387 lekë dëm ekonomik**, përkatësisht H.F 3,897 lekë (2,540+1,357), T.K 4,698 lekë dhe z. Th.A Shefi i shërbimeve vlera 18,792 lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr.10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **27,387 lekë** (3,897+4,698+18,792), përkatësisht nga H.F 3,897 lekë, T.K 4,698 lekë dhe z. Th.A Shefi i shërbimeve vlera 18,792 lekë, për diferenca të pajustificuara në harxhimin e artikullit pelet për ngrohje në shkollën 9-vjeçare, kopshti nr. 1, gjimnazin, pasi disponohet dokumentacion i parregullt dhe janë bërë dalje pelet padrejtësisht për periudha stinore të pa miratuara (*Muaji Prill*), si dhe për ditë festash zyrtare si dhe janë përfshirë orë të tepërta pune në trafiqet e konsumit për vitin 2013 dhe 2014.

Brenda datës 30.07.2015

10. Gjetje: Përveç daljeve të karburantit në adresë të shoferit të administratës, kaldajistëve, u konstatua se pa bazë ligjore, është bërë dalje karburant edhe për punonjësit e administratës të bashkisë, të cilët kanë firmosur fletëdaljet përkatëse, konkretisht:

-Sipas fletëdaljes nr. 11, datë 10.01.2013 është bërë dalje 250 litra benzinë për vlerën **42,242 lekë dëm ekonomik** në adresë të z. A.L me detyrë Kryetar i Bashkisë.

-Sipas flet daljes nr. 388, datë 26.9.2013 dhe urdhrit datë 26.9.2013 të Th.N është bërë dalje 100 litra naftë për vlerën **18,355 lekë dëm ekonomik** në emër të Th.N (*Andrea*,) me detyrë përgjegjës i sektorit shërbimeve të bashkisë.

-Sipas flet daljes nr. 246, datë 10.5.2013 dhe urdhrit datë 8.5.2013 të G.C është bërë dalje 60 litra naftë për vlerën **10,901 lekë dëm ekonomik** në emër të J.D me detyrë supervisor.

-Sipas flet daljes nr. 570, datë 12.11.2014 është bërë dalje 20 litra benzinë për vlerën **3,632 lekë dëm ekonomik** në emër të N.J me detyrë supervizore e bashkisë.

-Sipas flet daljes nr. , datë 16.9.2014 është bërë dalje 20 litra benzinë për vlerën **3,632 lekë dëm ekonomik** në emër të H.H me detyrë supervisor i bashkisë.

- Sipas flet daljes nr. 517, datë 21.10.2014 është bërë dalje 20 litra benzinë për vlerën **3,632 lekë dëm ekonomik**, në emër të O.L, me detyrë përgjegjës i burimeve njerëzore të bashkisë. Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **82,394 lekë**, për *përfitim të paligjshëm karburant* nga punonjësit e bashkisë, konkretisht: z. A.L 42,242 lekë sipas fletëdaljes nr. 11, datë 10.01.2013 përfituar 250 litra benzinë, Th.N 18,355 lekë sipas flet daljes nr. 388, datë 26.9.2013 për 100 litra naftë, G.C 10,901 lekë sipas flet daljes nr. 246, datë 10.5.2013 për 60 litra naftë, N.J 3,632 lekë sipas flet daljes nr. 570, datë 12.11.2014 për 20 litra benzinë, H.H 3,632 lekë sipas flet daljes datë 16.9.2014 për 20 litra benzinë dhe O.L 3,632 lekë sipas flet daljes nr. 517, datë 21.10.2014 për 20 litra benzinë.

Brenda datës 30.09.2015

11. Gjetje: Në 4 raste është bërë dalje karburant për Kamionin Volvo të bashkisë, rezulton se karburanti nuk justifikohet me dokumentacion, konkretisht:

-Sipas fletë daljes nr. 54, datë 28.01.2014 padrejtësisht është bërë dalje 40 litra naftë për transport pelet nga Korça në Ersekë, për vlerën **7,819 lekë dëm ekonomik**, pasi transporti i pelet mbulohet nga firma kontraktuese “Elbasan shpk”.

-Sipas flet daljes nr. 510, datë 25.11.2014 padrejtësisht është bërë dalje 50 litra naftë, për transport e heqje mbeturina të ndryshme në qytet, për vlerën **9,039 lekë dëm ekonomik**, pasi transporti dhe heqja e mbeturinave të qytetit mbulohet nga firma kontraktuese e pastrimit. Njëkohësisht procesverbali datë 5.11.2014 firmosur vetëm nga urdhërdhënësi është i parregullt .

-Sipas fletë daljeve nr. 37, datë 16.01.2014 dhe datë 25.02.2014 është bërë dalje 70 litra naftë, për transport bredha për mbjellje në rrugët e qytetit (*Rr. Deshmoreve*) për vlerën **12,808 lekë dëm ekonomik** (5284+7524), pasi nuk ka fletëhyrje për numërin e bredhave dhe nuk ka akt-marrje në dorëzim me komision, për efekt administrimit dhe inventarizimit tyre si dhe shmangies së abuzimeve nga mbjelljet e mëparshme dhe të mëpasme, çka bie ndesh me nenin 13 pika c të ligjit nr. 10.296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **29,666 lekë**, nga Th.A 5000 lekë, G.C 5,000 lekë, J.D 5,000 lekë P.R 5,000 lekë, B.M 9,666 lekë, për mos justifikimin me dokumentacion të 160 litra karburant, pasi transporti i pelet dhe mbeturinave mbulohet nga firmat sipërmarrëse kontraktuese.

Brenda datës 30.09.2015

12. Gjetje: : U konstatuan shkelje në veprimet e njësitë vartëse të bashkisë Ersekë, me efekte financiare për vlerën **63,806 lekë dëm ekonomik**, konkretisht:

-Vlera 4,700 lekë, dieta tepër, për vitin 2013 – 2014 në Qendrën Kulturore “Fan Noli”.

-Vlera 5,100 lekë, dieta tepër, për vitin 2013 - 2014 në “Klub Sportin Gramozi”.

Veprime në kundërshtim me pika1,Kapitulli IV, dhe kapitulli III i VKM nr. 997, datë 10.12.2014.

-Vlera 3,726 lekë për kamat vonesa, kaluar padrejtësisht në llogarinë e shpenzimeve operative, për mos likuidim në afat të shpenzimeve për shërbime telefonike të Qendrës Kulturore “Fan Noli “ Ersekë, për 8 subjekte.

-Vlera 10,380 lekë, për shpenzime të pa justifikuara (naftë për ngrohje), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikën 102.2 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012. "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit në përgjegjësinë e znj. Anila Çyçllari.

-Vlera 40,000 lekë, për shpenzimeve gjyqësore të paguara nga Klubi Sportiv “G.....” në vend të A.Ç, pasi padrejtësisht ka kaluar në zërin shpenzime operative, në kundërshtim me pika 6.1" *Vendime Gjyqësore*" e UMF nr. 4, datë 27.01.2011 dhe pika 102.2 e UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit”.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **63,806 lekë**, konkretisht:

-vlera 4,700 lekë, nga personat sipas aneksit nr. 6, bashkëlidhur

-vlera 5,100 lekë, nga personat sipas aneksit nr. 6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-vlera 3,726 lekë, për kamatëvonesa kaluar padrejtësisht në llogarinë e shpenzimeve operative, për mos likuidim në afat të shpenzimeve për shërbime telefonike të Qendrës kulturore Fan Noli Ersekë, për 8 subjekte, nga personat sipas aneksit nr. 6 .

-vlera 10,380 lekë, për shpenzime të pa justifikuara (naftë për ngrohje), për znj. Anila Çyçllari.

-vlëra 40,000 lekë, për shpenzimeve gjyqësore, për znj. Anila Çyclari, pasi padrejtësisht janë likuiduar nga Klubi Sportiv “Gramozi”, duke i kaluar në zërin shpenzime operative.

Brenda datës 30.07.2015

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 08.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, pjesa e VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 20.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërbllimin e dëmit në vlerën 12,681,209 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore dhe shkallët e gjykimit sa më poshtë:

13. Gjetje: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2014 me objekt “Sistemim i sheshit Rilindja”, rezultuan e shkelje në zhvillimin e procedurës së prokurimit, si në përcaktimit drejt të kriterëve të kualifikimit njësia e prokurimit dhe në vlerësimin dhe klasifikimin e pa drejtë, të ofertës fituese të operatorit ekonomik “A...”, i është shkaktuar buxheti të shtetit vlerën **10,945,217 lekë dëm ekonomik**, si rrjedhojë e mos barazisë në vlerësimin e pjesëmarrësve në tender.

Rekomandimi: Bashkia Ersekë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **10,945,217 lekë**, nga këta persona: **A.L, Th.N, A.D, T.Th, O.L, J.Zh**, dëm ekonomik i shkaktuar nga vlerësimi dhe klasifikimi i pa drejtë i ofertës së operatorit ekonomik “A...”, si rrjedhojë e mos barazisë në vlerësimin dhe klasifikimin e pjesëmarrësve në tender.

Brenda datës 30.09.2015

14. Gjetje: Në preventivin e paraqitur në tenderin me objekt “Sistemim i sheshit Rilindja”, nga operatori ekonomik “A.....”, janë përfshirë pajisjet me TVSH. Në preventiv janë paraqitur zërat e punës “pajisje” të llogaritur me gjithë vlerën e TVSH, pra nuk është ndarë veças vlëra e “montimit” dhe veças vlëra e pajisjeve, në kundërshtim UKM nr. 2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe në kundërshtim me UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3 datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar, përcaktohet qartë se si hartohet preventivi dhe situacioni përfundimtar, pra “pajisjet” preventivohen dhe situacionohen me vlerën me gjithë TVSH, e për rrjedhojë është rritur artificialisht vlëra e kontratës në shumën 417,000 lekë (2,085,000 x 20%), si dhe nga operatori ekonomik “AS”, vlëra e tvsh është përfutuar padrejtësisht në shumën **417,000 lekë dëm ekonomik** (2,085,000 x 20%) për buxhetin e shtetit.

Rekomandimi: Bashkia Ersekë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **417,000 lekë**, nga shoqëria “A.....” shpk, vlerë e përfutuar padrejtësisht, si rrjedhojë e preventivimit të pajisjeve të llogaritur me vlerën e TV.....SH.

Brenda datës 30.07.2015

15. Gjetje: Në preventivin e paraqitur në tenderin me objekt “Rikonstrukcion i sistemit të ngrohjes për 2 shkollat e qytetit Ersekë”, nga operatori ekonomik “M.....”, janë përfshirë pajisjet me TVSH. Në preventiv janë paraqitur zërat e punës “pajisje” të llogaritur me gjithë vlerën e TVSH, pra nuk është ndarë veças vlëra e “montimit” dhe veças vlëra e pajisjeve, në kundërshtim UKM nr. 2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe në kundërshtim me UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3 datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar, përcaktohet qartë se si hartohet preventivi dhe situacioni përfundimtar, pra “pajisjet” preventivohen dhe situacionohen me vlerën me gjithë TVSH, e për rrjedhojë është rritur artificialisht vlëra e kontratës në shumën 222,000 lekë (1,110,000 x 20%), si dhe nga operatori ekonomik “M..... shpk”, vlëra e tvsh është përfutuar padrejtësisht në shumën **222,000 lekë dëm ekonomik** (1,110,000 x 20%) për buxhetin e shtetit.

Rekomandimi: Bashkia Ersekë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **222,000 lekë**, nga

shoqëria “M...”, vlerë e përfitur padrejtësisht, si rrjedhojë e preventivimit të pajisjeve të llogaritur me gjithë vlerën e TVSH.

Brenda datës 30.07.2015

16.Gjetje: Nga auditimi rezultoi se janë dhënë me qira truall i lirë, për subjekte private që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Bashkisë Ersekë. Në kontratën e lidhur për vitin 2013 dhe 2014, nuk cilësohet subjekti përkatës i licencuar për ushtrim aktiviteti, por emri i qytetarit, ndërsa në fakt trualli shërben për ushtrim aktiviteti. Nga auditimi rezultoi se bashkia ka lidhur për vitin 2013 dhe 2014 kontrata për dhënie me qira truall i lirë. Për vitin 2014, kontratat janë lidhur mbështetur në VKM nr. 529 datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, kreu III, pika 1, germa “a”, paragrafi i pestë dhe nga bashkia Ersekë, qiraja e 1 m2 truall është përcaktuar 20 lek/m2. Në paragrafin e pestë të germën “a”, nuk rezulton të përcaktohet kjo vlerë, e për rrjedhojë kjo bashki ka përdorur reference të gabuar. Pra në germën “b”, përcaktohet tarifa, në rastin kur sipas germës “a”, është dhënë me qira “ndërtesë”, që ka truall funksional. Në rastin konkret, bashkia ka dhënë me qira vetëm truall të lirë dhe nuk ka dhënë me qira ndërtesë që ka edhe truall funksional. Bashkia Ersekë, duhej të përcaktonte tarifën e qirasë sipas pikës 1, germa “c” ku cilësohet se: “Për truallin e lire, tarifa dysHEME e qirasë mujore është 100 lekë/m2”. Si rrjedhojë e aplikimit gabim të tarifës, buxhetit të shtetit i është shkaktuar për vitin 2014 dhe vitin 2013 vlera **1,096,992 lekë dëm ekonomik** (671.35 m2 x 80 lek/muaj x 24 muaj). Bashkia Ersekë për vitin 2014, ka ripërtërirë kontratat edhe për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet e vitit 2013. Rezulton se 13 subjekte, që kanë lidhur kontratë për vitin 2014 dhe 2013, nuk është shlyer edhe qiraja mujore me vlerë prej 20 lek/m2, e përcaktuar në kontratë, me vlerën 336,002 lekë.

Kontratat e qirasë për vitin 2014, janë lidhur me objekt “Truall i lire funksional” (jo ndërtesë), mbështetur në VKM nr. 529 datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, kreu III, pika 1, germa “a”, paragrafi i pestë”. Për vitin 2014, kontrata e qirasë, duhej ti referohej VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, kreu III, pika 2, “Kur jepet me qira truall i lire, pra kur jepet me qira ose enfiteozë vetëm truall, tarifa dysHEME e qirasë mujore është 100 lekë/m2.

Rekomandimi: Bashkia Ersekë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës **1,096,992 lekë**, nga **15 subjekte**, konkretisht: Banka S..., A.Xh, F.Dh, N.L, B.M, R.D, A.I, G.Z, Q.H, I.H, A.P, B.Z, E.T, B.Z, F.M, si rrjedhojë e aplikimit dhe llogaritjes gabim të tarifës për dhënie me qira të truallit të lirë.

Brenda datës 30.07.2015

C. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenin 5/b të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014 dhe nenin 15 “Sanksionet”, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, **i kemi kërkyer:**

- **Kryetarit të Bashkisë Ersekë ti propozojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore të Qarkut Korçë**, që ka në juridiksion territorin ku ndodhen objekti i trajtuar sipas kontratës (duke i bashkëlidhur fotokopjen e procesverbalit përkatës që trajton çështjen), që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, *duke vendosur sanksionet si më poshtë:*

a. “Masë me gjobë”, për

1. z. M.T, mbikëqyrës i punimeve të ndërtimit në objektin “Sistemim i sheshit Rilindja”, për shkeljet këto ligjore:

- Disa zëra punimesh janë situacionuar pa u realizuar në fakt, sipas situacioneve pjesore nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të vitit 2014, për pasojë duke krijuar efekte financiare në vlerën **20 milion lekë pa TVSH**,

në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe kontratën datë 25.7.2014.

Brenda datës 30.06.2015

-Për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

Mbështetur në nenet 10, 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92, datë 19.02.2014, Kreu VII, “Sanksione”, pika 1, shkronja (a), Pika I- “Konstatohen ose provohen deklarime, të rreme”, **i kemi rekomanduar;**

-Komisionit të dhënies së Licencave, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, që për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet si më poshtë:

- Heqjen e Licenses, për një afat 1 vit” për mbikëqyrësin e punimeve të ndërtimit z. M.T, në objektin “Sistemi i sheshit Rilindja Ersekë”, për shkak se:

-Disa zëra punimesh janë situacionuar, pa u realizuar në fakt sipas situacioneve pjesore nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të vitit 2014 dhe janë likuiduar, për pasojë duke krijuar efekte financiare negative në vlerën **20 milion lekë pa TVSH,** në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar si dhe me kontratën datë 25.7.2014 ..

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 58 germa ç, c, b, a “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 8 të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31/7/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i kemi **kërkuar** kryetarit të Bashkisë Ersekë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje” deri në “Largim nga puna”** dhe për ata me kontratë, nga masa **“Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”,** për këta punonjës:

1. z. P.R, me detyrë përgjegjës i sektorit financës dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues, për shkeljet e mëposhtme:

-Për lejimin e likuidimit të vlerës 20 milion lekë, për punime të pakryera në zërin “shtrim pllaka guri dhe zëra të tjerë” në investimin: “Rikonstrukcion sheshi Rilindja Erseke”, sipas urdhër shpenzimeve nr. 407 datë 15.09.2014, nr. 451 datë 17.10.2014 dhe nr. 566 datë 19.12.2014, në kundërshtim me kërkesat e pikave 147, 152, 154, 156, 157, 158 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me nenet 2, 5, 8/1, 12/3/ dhe e, 13/1/ a, c e ç të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me pikën 36,54 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me nenet 4/ç dhe 21 të ligjit nr. 9936, datë 26.6. 2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH dhe me kontratën datë 25.7.2014.

-Për lejimin e krijimit të vlerës 1,284,750 lekë dëm ekonomik, me veprimet e bankës për vitin 2013 - 2014, e përbërë nga: blerje dhe shërbime të vogla të paligjshme në vlerën 221,985 lekë, shpenzime celulare mbi kufirin ligjor 100,000 lekë, dieta tepërta 88,920 lekë, pritje-përcjellje pa ligjshme 137,645 lekë, shpenzime pastrimi të paligjshme 736,200 lekë, , në kundërshtim me Udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 2, datë 28.3.2013 “Për procedurën prokurimit me vlera vogla”, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik”, me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave juridikë, publikë”,

me VKM nr. 997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, me VKM nr. 243 datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin e delegacioneve të huaja” ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999, me nenin 12 , 17, 20 të kontratës sipërmarrëse datë 3.5.2010, me nenin 18, kapitulli i IV, pika 1, 2/a,b etj të rregullores brendshme të bashkisë, miratuar në KB sipas vendimit nr. 22, datë 21.4.2010.

-Për mos kontroll në administrimin e karburantit dhe artikujve ngrohës pelet me veprimet e magazinës për vitin 2013 dhe 2014 ku u konstatua vlera 293,705 lekë dëm ekonomik, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

-Për 1 rast diskriminimi të radhës së likuidimeve midis subjekteve, sipas urdhër shpenzimit nr. 93, datë 18.3.2014 dhe urdhër shpenzimit nr. 301, datë 22.10.2013 në kundërshtim me pikën 101 të UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Për mos kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë për vitin 2013, përkatësisht: për shkollën e mesme, shkollën 9-vjeçare, konviktin çerdhen, zdrukthëtarinë, dekorin, makinat, në kundërshtim me pikën 81,82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89 dhe 90 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik “.

-Për mos ndjekje detyrimeve të krijuara nga mos arkëtimi i vlerës së ushqimit të konviktorëve për shumën 69,674 lekë dhe 44,420 lekë.

-për mos rakordimin e detyrimeve të krijuara nga mos mbledhja e taksave dhe tarifave vendore nga popullata (familjarët) taksë pasurie, tarifë pastrimi, tarifë ndriçimi për vlerën 108,228 lekë.

-për mos ndjekjen në vazhdimësi të detyrimeve të krijuar nga mos arkëtimi i taksave të popullatës e për rrjedhojë ka ardhur rritja e tepricës së gjendjes debitorë dhe konkretisht : në vitin 2012, vlera 684,527 lekë, në vitin 2013 për 874,228 lekë dhe në vitin 2014 në vlerën 1,021,900 lekë .

- Për mos pasqyrimin në bilancin e vitit 2014 në llogarinë “”investime në proces” të investimit “Rikonstrukcion sheshi Rilindja”, por gabimisht është pasqyruar në llogarinë 213 si investim i përfunduar, në kushtet e mungesës së akt marrjes dorëzim e kolaudit, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

-Për mos rekordim të tepricës së llogarisë 312 dhe 327 për vlerën 202,522 lekë, krahasuar me gjendjen e paraqitur në llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” , në formatin 3/1 “Përshkrimi i shpenzimeve të ushtrimit” .

2. Th.A (N), me detyrë përgjegjës i sektorit shërbimeve dhe në cilësinë e kryetarit të KVO, për shkeljet e mëposhtme:

- Ka shqyrtuar ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik në tenderët e zhvilluara për periudhën viti 2013 dhe 2014, në kundërshtim me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53 “shqyrtimi i ofertave”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar kreu V “zhvillimi i procedurave”, duke kualifikuar ofertues të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim ose duke s,kualifikuar ofertues të cilët i plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktues në DST.

Këto shkelje janë konstatuar në tenderët e zhvilluar:

Në vitin 2014 me objekt:

1. “Sistemim i sheshit Rilindja” me vlerë të prokuruar të kontratës 43,822 mijë lekë.

2“Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshtit nr. 1” , me vlerë të prokuruar të kontratës 1,667 mijë lekë.

3. “Blerje gazoil e benzinë për ngrohjen e kopshtit nr. 2 dhe automjetet e Bashkisë Ersekë”, me vlerë të prokuruar të kontratës 967 mijë lekë.

Në vitin 2013 me objekt:

1.“Blerje lëndë djegëse për ngrohje, briket pellet”, me vlerë të prokuruar të kontratës 833 mijë lekë.

2. “Rikonstrukcion i sistemit të ngrohjes për 2 shkollat e qytetit Ersekë”, me vlerë të prokuruar të kontratës 1,667 mijë lekë.

3. “Blerje gazoil për ngrohje si dhe benzine për automjetin e Bashkisë”, me vlerë të prokuruar të kontratës 1,325 mijë lekë.

-Për mos kontroll të supervisorëve për shërbimin e pastrimit të qytetit, pasi nuk kanë pasqyruar dhe evidentuar zbritjet e volumeve të pakryera ndaj firmës sipërmarrëse për vlerën 736,200 lekë dëm ekonomik, konkretisht zëri “*pastrimit ose fshirjes rrugëve e trotuarve e sheshit Rilindja te qytetit*”, për sipërfaqen 3,296 m², që bën fjalë për rikonstrukcionin e sheshit të qytetit me tenderim, për 6-mujorin e II të vitit 2014 dhe janar-shkurt 2015, në kundërshtim me kontratën e pastrimit dhe rregulloren e brendshme bashkisë.

-Për mos zhvillim tenderi për blerjen e ushqimeve për vitin 2013 për vlerën 989,000 lekë dhe për vitin 2014 për vlerën 791,000 lekë, por është proceduar me prokurim të drejtpërdrejtë duke copëzuar fondin me vlera nën 400 mijë lekë, për grup mallrash ushqimor të njëjta brenda vitit kalendarik 2013 dhe 2014, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” ndryshuar, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, me kreun II “*Rregullat e përgjithshme të prokurimit*” pika 1 “*Kufijtë monetarë*” shkronja B, me kreun IV shkronja C, me UAPP nr. 02, datë 28.03.2013 “*Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla*” pika 1 dhe 4, ndryshuar me UAPP nr. 5, datë 16.7.2013 dhe nr. 01, datë 28.02.2014.

-Për lëshimin e disa urdhra të parregullt për daljet e disa artikujve nga magazina dhe krijimin e vlerës 108,758 lekë dëm ekonomik, për karburant të pa justifikuar jashtë destinacionit të miratuar dhe për diferenca karburanti të rezultuara nga rekordimi i km të përshkuara- furnizimet-normativat për kamionin Volvo për vitin 2013 dhe 2014.

3. G.C me detyrë specialist i sektorit shërbimeve dhe në cilësinë e anëtarit të KVO,

4. z. A.D, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për arsye se:

për shkeljet e mëposhtme:

- Kanë shqyrtuar ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik në tenderët e zhvilluara për periudhën viti 2013 dhe 2014, në kundërshtim me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 53 “*shqyrtimi i ofertave*”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar kreu V “*zhvillimi i procedurave*”, duke kualifikuar ofertues të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim ose duke s’kualifikuar ofertues të cilët i plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktues në DST.

Këto shkelje janë konstatuar në tenderët e zhvilluar:

Në vitin 2014 me objekt:

1. “Sistemim i sheshit Rilindja” me vlerë të prokuruar të kontratës 43,822 mijë lekë.

2. “Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshtit nr. 1”, me vlerë të prokuruar të kontratës 1,667 mijë lekë.

3. “Blerje gazoil e benzinë për ngrohjen e kopshtit nr. 2 dhe automjetet e Bashkisë Ersekë”, me vlerë të prokuruar të kontratës 967 mijë lekë.

Në vitin 2013 me objekt:

1. “Blerje lëndë djegëse për ngrohje, briket pelet”, me vlerë të prokuruar të kontratës 833 mijë lekë.

2. “Rikonstrukcion i sistemit të ngrohjes për 2 shkollat e qytetit Ersekë”, me vlerë të prokuruar të kontratës 1,667 mijë lekë.

3. “Blerje gazoil për ngrohje si dhe benzine për autoveturën e Bashkisë”, me vlerë të prokuruar të kontratës 1,325 mijë lekë.

-Për krijimin e vlerës 108,758 lekë dëm ekonomik, për karburant të pa justifikuar jashtë destinacionit të miratuar dhe për diferenca karburanti të rezultuara nga rekordimi i km të përshkuara- furnizimet-normativat për kamionin Volvo për vitin 2013 dhe 2014.

-Për mos justifikimin e disa shpenzimeve sipas fletëdaljeve për materiale ndërtimi dhe elektrike, të cilat nuk shoqërohen me dokumente justifikuese, për efekt të argumentimit tyre, si: preventiva, situacione, skicime të përmasuara, fotografime të vendeve dëmtuara etj., çka kanë sjellë efekte financiare për vlerën 201,565 lekë.

-Për mos justifikimin e karburantit me dokumentacion në 4 raste me vlerën 29,666 lekë dëm ekonomik, bërë dalje kamionit Volvo të bashkisë, me urdhër të tij.

-Për mos justifikimin e disa materialeve ndërtimi dhe elektrike sipas fletëdaljes nr. 351 datë 3.09.2013 në adresë të shkollës mesme dhe konviktit, pasi nuk shoqërohen me preventiv dhe situacion sipas zërave të punës.

5. J.Zh me detyrë specialist i sektorit shërbimeve dhe në cilësinë e specialistit të Njesisë së Prokurimeve,

6. O.L , me detyrë përgjegjës i Burimeve njerëzore dhe në cilësinë e anëtarit njesisë prokurimeve publike, për shkeljet e mëposhtme:

a. Dosjet e tenderëve nuk janë inventarizuar. Autoriteti kontraktues nuk ka bërë arkivimin e procedurave të prokurimit në kundërshtim me udhëzimin e APP-së dhe në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

b. Në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim i sheshit Rilindja”, në DST nuk janë përcaktuar saktë kriteret e vlerësimit :

-Në Kriteret e veçanta të kualifikimit, “Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë”. është kërkuar: “Operatori duhet të jetë i pajisur me kategoritë e licencave për punimet sipas projektit përkatës”. Ky kriter i përcaktuar nga njësia e prokurimit dhe i miratuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave, nuk është i saktë, është lënë evazive dhe lë shteg për abuzim. Duhej përcaktuar saktë kërkesa për kategoritë e punimeve që duhet të ketë licenca profesionale e shoqërisë, për kryerjen e punimeve sipas zërave të punës që përmban preventive i punimeve, në mospërputhje me DST-“ Liçensa profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës”.

-Në kriterin “Dëshmi për punime të ngjashme”, është kërkuar vetëm kriteri-Dëshmi për punime të ngjashme me objektin e prokurimit të realizuara gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më pak se 70,000,000 lekë, e vlerës të përlllogaritur të kontratës që prokurohet në shumën jo më pak se 52,585,998 lekë, ndërsa duhej kërkuar edhe kriteri “Punë të ngjashme për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë në një vlerë deri në 40% të vlerës së fondit limit, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, siç përcaktohet në DST

-Në dokumentet e tenderit, në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një fletë analizë të materialit të gurit nga autoriteti shtetëror shqiptar. Operatori të paraqesë kampionin e pllakave të gurit të përmasave 20x20x15, në datën e hapjes së ofertave në orën e caktuar si dhe flet analizën për llojin e gurit, por nga autoriteti kontraktor nuk janë hartuar specifikimet teknike të gurit, ku detyrimisht duhej të përcaktohej si fortësia e gurit, ngjyra e gurit, etj.

Në DST e hartuar nga autoriteti kontraktor, pas faqes nr.26, është vendosur një fletë, pa emërtim, pa numër rendor dhe përmbajtja nuk është në gjuhën shqipe siç përcaktohet në DST, por është në gjuhë të huaj dhe nuk cilëson se çfarë përcakton, në mospërputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 1, “Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara”, pika 2, “Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik, pika 3, “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktues.

Gjithashtu në këtë kriter nuk është përcaktuar saktë ku cilësohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një fletë analizë të materialit të gurit nga autoriteti shtetëror shqiptar”, ndërsa duhej cilësuar “Laborator i certifikuar nga autoriteti shtetëror shqiptar”.

-Për mos kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë për vitin 2013, përkatësisht: për shkollën e mesme, shkollën 9-vjeçare, konviktin çerdhen, zdrukthëtarinë, dekorin, makinat, në kundërshtim me pikën 81,82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89 dhe 90 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

7. Z.T.Thoma, veteriner dhe anëtar komisioni i blerjeve të vogla si dhe në cilësinë e anëtares të KVO, për shkeljet e mëposhtme:

8. J.D, supervisor dhe anëtar i komisionit blerjeve të vogla dhe inventarizimit pasurisë:

- Kanë shqyrtuar ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik në tenderët e zhvilluara për periudhën viti 2013 dhe 2014, në kundërshtim me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53 “shqyrtimi i ofertave”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar kreu V “zhvillimi i procedurave”, duke kualifikuar ofertues të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim ose duke skualifikuar ofertues të cilët i plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktues në DST.

Këto shkelje janë konstatuar në tenderët e zhvilluar:

Në vitin 2014 me objekt:

1. “Sistemim i sheshit Rilindja” me vlerë të prokuruar të kontratës 43,822 mijë lekë.

2. “Blerje pellet për ngrohjen e shkollave dhe kopshtit nr. 1” , me vlerë të prokuruar të kontratës 1,667 mijë lekë.

3. “Blerje gazoil e benzinë për ngrohjen e kopshtit nr. 2 dhe automjetet e Bashkisë Ersekë”, me vlerë të prokuruar të kontratës 967 mijë lekë.

Në vitin 2013 me objekt:

1. “Blerje lëndë djegëse për ngrohje, briket pellet”, me vlerë të prokuruar të kontratës 833 mijë lekë.

2. “Rikonstrukcion i sistemit të ngrohjes për 2 shkollat e qytetit Ersekë”, me vlerë të prokuruar të kontratës 1,667 mijë lekë.

3. “Blerje gazoil për ngrohje si dhe benzine për autoveturën e Bashkisë ”, me vlerë të prokuruar të kontratës 1,325 mijë lekë.

-Për shkelje në 2 raste në blerjet e vogla me efekte financiare për vlerën 221,985 lekë dëm ekonomik, në kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 2, datë 28.3.2013 “Për procedurën prokurimit me vlera vogla”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik”.

-Për mos kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë për vitin 2013, përkatësisht: për shkollën e mesme, shkollën 9-vjeçare, konviktin çerdhen, zdrukthëtarinë, dekorin, makinat, në kundërshtim me pikën 81,82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89 dhe 90 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

9. Gj.K me detyrë Përgjegjës i zyrës së Taksave dhe tarifave vendore, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mosrealizim të ardhurave të taksave vendore 75 % për vitin 2013 dhe 80 % për vitin 2014.

-Për lejimin e rritjes të detyrimeve të institucioneve shtetërore ndaj Bashkisë Ersekë për vlerën 416.000 lekë, dhe detyrimeve të subjekteve juridike të cilat janë rritur 4-fish krahasuar me 2012.

-nuk janë arkëtuar detyrimet e trashëguara nga vitit 2012 për subjektet fizike shtuar ato për vlerën 910,342 lekë ose 1.46 herë. Për vitin 2014, teprica e debitorëve nga kjo kategori biznesi është pakësuar vetëm 85,342 lekë krahasuar me gjendjen e rezultuar më 31.12.2013.

-Për mos mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore nga popullata (Taksë pasurie, tarifë pastrimi dhe tarifë ndriçimi) të cilat rezultojnë me rritje dhe konkretisht : në vitin 2012 rezultojnë në vlerën 684,527 lekë, në vitin 2013 për 874,228 lekë dhe në vitin 2014 në vlerën 1,021,900 lekë ose për vlerën 108,228 lekë më shumë detyrime të taksës familjare.

-Për mos aplikim dhe mos zbatim të masave shtrënguese për subjektet që nuk kanë respektuar afatin e pagesës së taksave dhe tarifave vendore.

-Për detyrimet e pa likuiduara në afat nga subjektet në vlerën 1,589,109 lekë dhe mos penalizim për 25% në shumën 397,283 lekë.

-Për 12 subjekte që kanë zhvilluar aktivitet pa u pajisur me certifikatë për vitin 2013 dhe 15 subjekte për vitin 2014. Këto subjekte nuk janë ndjekur e monitoruar duke bërë që të mos gjenerojnë detyrimet disa prej tyre me efekt negativ në të ardhurat e buxhetit të bashkisë për vlerën 544 mijë lekë.

-Për mos ndjekjen e arkëtimin e gjobave të vendosura në vitin 2012, 2013, 2014 për shumën 470,000 lekë.

Veprime në kundërshtim me ligjin 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, i ndryshuar me ligjin 10117, datë 23.04.2009.

10. N.J, supervizore, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos mbikëqyrjen e plotë dhe periodike të shërbimit pastrimit të qytetit, pasi nuk ka mbajtur procesverbale dhe situacione ditore, për efekt të evidentimit të saktësisë së kryerjes së volumeve dhe cilësisë zërave të punimeve të pastrimit, për pasojë nuk janë pasqyruar dhe evidentuar zbritjet e volumeve të pakryera ndaj firmës sipërmarrëse për vlerën 736,200 lekë dëm ekonomik, për 6-mujorin e II të vitit 2014 dhe janar-shkurt 2015, nuk është zbritur firmës pastrimit zëri i punës “pastrimit ose fshirjes rrugëve e trotuareve të sheshit Rilindja te qytetit”, për sipërfaqen 3,296 m², që bën fjalë për rikonstruksionin e sheshit të qytetit me tenderim sipas kontratës datë 25.7.2014 të kontraktorit, në kundërshtim me kontratën e pastrimit dhe rregulloren e brendshme bashkisë.

11. H.H, supervizor, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos mbikëqyrjen e plotë dhe periodike të shërbimit pastrimit të qytetit, pasi nuk ka mbajtur procesverbale dhe situacione ditore, për efekt të evidentimit të saktësisë së kryerjes së volumeve dhe cilësisë zërave të punimeve të pastrimit, për pasojë nuk janë pasqyruar dhe evidentuar zbritjet e volumeve të pakryera ndaj firmës sipërmarrëse për vlerën 736,200 lekë dëm ekonomik, për 6-mujorin e II të vitit 2014 dhe janar-shkurt 2015, nuk është zbritur firmës pastrimit zëri i punës “pastrimit ose fshirjes rrugëve e trotuareve e sheshit Rilindja te qytetit”, për sipërfaqen 3,296 m², që bën fjalë për rikonstruksionin e sheshit të qytetit me tenderim sipas kontratës datë 25.7.2014 të kontraktuesit, në kundërshtim me kontratën e pastrimit dhe rregulloren e brendshme bashkisë.

12. Anila Çyçllari, me detyrë përgjegjëse e financës në Klubin Sportiv “Gramozi” dhe Qendrën Kulturore “Fan Noli”:

-për pagesën e shpenzimeve gjyqësore për vlerën 40.000 lekë , në kundërshtim me udhëzimin nr 4. datë 27.01.2011, pika 6.1" *Vendime Gjyqësore*" dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012. "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit*" pika 102.2 .-- për mos zbatimin e VKM nr. 997, datë 10.12.2010 kapitulli III, pika 1 dhe Kapitulli IV , nga zyra e financës, pasi janë kryer 9,800 lekë pagesa tepërta për shpenzime udhëtime për vitin 2013 dhe 2014.

-për kryerjen e pagesës për kamatëvonesë të pa justifikuar, në vlerën 3,726 lekë, për 8 raste, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” si dhe të UMF nr. 2, datë 06.02.2012. "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit*", pika 102.2.

Për mos zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” si dhe Udhëzimit nr .2, datë UMF nr. 2, datë 06.02.2012. "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit*" pika 102.2, pasi është shpenzuar vlera 10280 lekë për 60 litra naftë të blerë për ngrohje të ambienteve të bibliotekës, shpenzim i pa justifikuar në stinën e verës, sipas urdhër shpenzimit nr. 50, datë 11.07.2013.

13. S.V, llogaritar-arkëtare dhe anëtare komisioni të blerjeve të vogla dhe inventarizimit pasurisë, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mangësi në mbajtjen e dokumentacionit të magazinës dhe mungesë kontrolli në administrimin e karburantit dhe artikujve ngrohës pelet për vitin 2013 dhe 2014, ku u konstatua vlera 293,705 lekë dëm ekonomik, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Për shkelje në 2 raste në blerjet e vogla me efekte financiare për vlerën 221,985 lekë dëm ekonomik, në kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 2, datë 28.3.2013 “Për

procedurën prokurimit me vlera vogla”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitet sektorit publik”.

-Për mos kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë për vitin 2013, përkatësisht: për shkollën e mesme, shkollën 9-vjeçare, konviktin çerdhen, zdrukthëtarinë, dekorin, makinat, në kundërshtim me pikën 81,82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89 dhe 90 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”.

-Për mangësi në nxjerrjen jashtë përdorimit të disa pajisjeve kompjuterike, në kushtet e mungesës së procesverbalit të specialistit fushës dhe mungesës të vitit të blerjes, faktorë bazë që provojnë se pajisjet kanë humbur vlerën e përdorimit, në kundërshtim me pikën 95 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”.

-Për mos rekordim të fletudhëtimeve me urdhërshërbimet, çka ka krijuar dublime pagesash me efekte financiare 12,500 lekë.

14. L.Q, me detyrë sekretar i Këshillit Bashkiak,

për mos dërgimin zyrtarisht të listë prezencës për disa këshilltarë bashkiak të cilët nuk kanë marrë pjesë mbledhje dhe janë paguar padrejtësisht për vlerën 445,200 lekë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”, me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, sipas protokollit të mbledhjes të Këshillit Bashkiak nr. 01 datë 16.01.2013, nr. 3 datë 1.3.2013, nr. 4 datë 26.03.2013, nr. 5 datë 30.4.2013, nr. 6 datë 6.6.2013, nr. 9 datë 30.8.2013, nr. 10 datë 4.10.2013, nr. 02 datë 28.02.2014, nr. 3 datë 28.3.2014, nr. 6 datë 18.7.2014, nr. 8 datë 2.10.2014 dhe nr. 9 datë 10.11.2014.

15. A.L, magazinierë, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mangësi në mbajtjen e dokumentacionit të magazinës dhe lejimin e harxhimit të karburantit dhe artikujve ngrohës pelet për vitin 2013 dhe 2014 pa siguruar ngjitur disa fletëdaljeve dokumente justifikuese, për rrjedhojë u konstatua vlera 293,705 lekë dëm ekonomik.

- Për mos rekordim për çdo artikull mes llogaritares dhe magazinieres në librin e magazinës.

16. B.H, polic bashkiak, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos hartim dhe miratim të planeve të punës për vitin 2014 në zbatim të ligjit dhe në koordinim me të gjitha zyrat tjera të cilat veprojnë brenda strukturave të bashkisë, veprime në kundërshtim me detyrat e përcaktuara në ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 ndryshuar me ligjin nr. 8385, datë 23.04.1998 “Për policinë bashkiake e të komunës”, me Rregulloren e Brendshme “Tip” të Policisë së Bashkisë dhe të Komunës, miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Rendit Publik dhe me detyrat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.

-Për mungesën e librit shërbimit me të dhënat e lëvizjes së policëve bashkiakë sipas detyrave përkatëse në zbatim të planit mujorë.

-Për mos pasqyrimin në regjistër të ankesave të qytetarëve dhe mos informim me shkrim për zbatimin e urdhrave të Kryetarit të Bashkisë,

- Për punë të pamjaftueshme për vitin 2013 dhe 2014 dhe bashkëveprim të dobët me sektorët e taksave vendore dhe INUV për disiplinimin e subjekteve fizike debitorë e të pa licënuara si dhe e ndërtimeve të paligjshme.

17. A.B, polic bashkiak, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos hartim dhe miratim të planeve të punës për vitin 2014 në zbatim të ligjit dhe në koordinim me të gjitha zyrat tjera të cilat veprojnë brenda strukturave të bashkisë, veprime në kundërshtim me detyrat e përcaktuara në ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 ndryshuar me ligjin nr. 8385, datë 23.04.1998 “Për policinë bashkiake e të komunës”, me Rregulloren e Brendshme “Tip” të Policisë së Bashkisë dhe të Komunës, miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Rendit Publik dhe me detyrat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.

-Për mungesën e librit shërbimit me të dhënat e lëvizjes së policëve bashkiakë sipas detyrave përkatëse në zbatim të planit mujorë.

-Për mos pasqyrimin në regjistër të ankesave të qytetarëve dhe mos informim me shkrim për zbatimin e urdhrave të Kryetarit të Bashkisë,
- Për punë të pamjaftueshme për vitin 2013 dhe 2014 dhe bashkëveprim të dobët me sektorët e taksave vendore dhe INUV për disiplinimin e subjekteve fizike debitorë e të pa licensuara si dhe e ndërtimeve të paligjshme.

III. Mbështetur në nenin 59 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në nenin 72 “Kundërvajtjet administrative”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, i propozohet, APP (Agjencinë e Prokurimit Publik) dhënia e masave administrative, për KVO dhe njësinë e hartimit të dokumenteve të tenderit, për punonjësit: Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve për periudhën 01.01.2012 deri më 30.06.2014, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet përkatëse, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në mbështetje të nenit 10,15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i kemi rekomanduar Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktues (për marrjen e masave disiplinore).

A. 1. Për z. A.J, me detyrë Kryetar i Bashkisë Ersekë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

B. Për anëtarët e njësisë së prokurimit:

2. z. O.L, në cilësinë e specialistit të Njësisë së Prokurimeve.

3. z. J. Zh, në cilësinë e specialistit të Njësisë së Prokurimeve.

C. Për anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

4. z. Th. N në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

5. z. A.D,

6. znj.T. Th,

7. z. G.Ç, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për arsye se:

- Kanë shqyrtuar ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik në tenderët e zhvilluara për periudhën viti 2013 dhe 2014, në kundërshtim me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53 “shqyrtimi i ofertave”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar kreu V “zhvillimi i procedurave”, duke kualifikuar ofertues të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim ose duke skualifikuar ofertues të cilët i plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktues në DST.

Këto shkelje janë konstatuar në tenderët e zhvilluar:

Në vitin 2014 me objekt:

1. “Sistemim i sheshit Rilindja” me vlerë të prokuruar të kontratës 43,822 mijë lekë.

2.“Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshtit nr. 1” , me vlerë të prokuruar të kontratës 1,667 mijë lekë.

3. “Blerje gazoil e benzinë për ngrohjen e kopshtit nr. 2 dhe automjetet e Bashkisë Ersekë”, me vlerë të prokuruar të kontratës 967 mijë lekë.

Në vitin 2013 me objekt:

1.“Blerje lëndë djegëse për ngrohje, briket pelet”, me vlerë të prokuruar të kontratës 833 mijë lekë.

2. “Rikonstrukcion i sistemit të ngrohjes për 2 shkollat e qytetit Ersekë”, me vlerë të prokuruar të kontratës 1,667 mijë lekë.

3. “Blerje gazoil për ngrohje si dhe benzine për automjetin e Bashkisë”, me vlerë të prokuruar të kontratës 1,325 mijë lekë.

Nga Bashkia Ersekë, nuk është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet nuk janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Besim Bileri, Milo Pano, Bashkim Shehu dhe Skënder Muça, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT